



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	03.08.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abdurrahman URUQI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në komunën e Ferizajt
CC:	z. Muharrem SVARQA Kryetar i Komunës së Ferizajt
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin " Furnizimi i fermerëve me fidanë të mjedrave dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë për ngritjen e pemishteve me mjedra, Komuna Ferizaj "

I nderuari z. Uruqi,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " **Furnizimi i fermerëve me fidanë të mjedrave dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë për ngritjen e pemishteve me mjedra, Komuna Ferizaj**" me numër prokurimi: 656 15 273 121:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Furnizimi i fermerëve me fidanë të mjedrave dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë për ngritjen e pemishteve me mjedra, Komuna Ferizaj**" me numër prokurimi: 656 15 273 121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna e Ferizajt si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës për Prokurim ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " **Furnizimi i fermerëve me fidanë të mjedrave dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë për ngritjen e pemishteve me mjedra, Komuna Ferizaj**" me numër prokurimi: 656 15 273 121, të cilat janë publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.14.07.2015. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 14.07.2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknike dhe profesionale pika 1. **Ka kërkuar që Fidanet të jenë të tipit Polka**, kërkesë kjo e cila konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik me përcaktimin e emrit të prodhuesit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund ti referohet një standardi vendor, European ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkojë emërtimi i të këtyre mallrave.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formulojë specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë ti diskriminojë Operatorët tjerë ekonomik, si dhe të mos caktoj kërkesa të cilat do ti pengonin operatorët ekonomik për të dorëzuar tenderët e tyre.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

AKK gjatë shfletimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se në Dosjen e Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit në rubrikën 13.2-Siguria e Tenderit, autoriteti kontraktues ka kërkuar sigurinë e tenderit në vlerë prej 1,000.00€ nga vlera e ofertës me validitet **90 ditë**, si dhe tek rubrika 21.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë **90 ditë**.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik, siguria e tenderit duhet të kërkojë për një periudhë prej tridhjetë(30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Në këtë rast

Autoriteti Kontraktues dot duhej që validitetin e sigurisë së tenderit ta kërkonte në periudhë prej 120 ditëve.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **28** Specifikimet teknike nenin **69** Aftësitë teknike dhe/ose profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042,dhe dhe nenin **26** Siguria e Tenderit të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !